



LAGUNA ARTIFICIALE PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË ZEZA
SISTEMET E PASTRIMIT TË UJIT NATYRAL

IDEASS ^{ITALI}

Inovacione për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Jug - Jug

www.ideassonline.org

Hyrje

Teksti i shkruar nga Beatrice Pucci, Agjensia Rajonale për Mbrojtjen Mjedisore të Toskanës

Çdo proces i pastrimit të ujit kërkon të zvogëlojë nivelin e ndotësve të pranishëm në ujë me anë të agjentëve biologjikë. Procesi ndodh në mënyrë spontane në të gjitha sistemet hidro- natyrale dhe garanton kapacitetin e tyre “vetë –pastrues”.

Sistemet e pastrimit të ujit natyral të Lagunave artificiale për trajtimin e ujërave të zeza shfrytëzojnë një proces që ndodh në mënyrë spontane në natyrë, duke optimizuar proceset biologjike për të siguruar nivele më të larta pastrimi.

Këto sisteme u aplikuan për herë të parë në Gjermani në 1952 të ndjekura nga një seri eksperimentesh të realizuara nga Instituti Max Planck. Në vijim, disa vende europiane si (Francë, Angli, Austri, Danimarkë, Itali, Hollandë, Zvicër) aktivizuan programe specifike kërkimi dhe pas krahasimeve të gjera specifike u përpiluan Udhëzimet Europiane.

Avantazhet më të dukshme ekonomike që zvogëlojnë kostot operative dhe reduktojnë konsumin e energjisë dhe nivelet optimale të pastrimit i kanë nxitur disa vënde për të adoptuar sistemin në një shkallë të gjerë në radhë të parë për aplikimet e vogla dhe të mesme, por gjithashtu dhe për pastrimin e ujit të papërdorshëm nga sistemet teknologjike. Në rastin më të fundëm uji i trajtuar mund të ripërdoret në bujqësi në industri dhe përgjithësisht për qëllime jo pirjeje. Ripërdorimi në mënyrë të saktë i ujit të papërdorshëm të

pastruar kontribuon në një reduktim të dukshëm për përdorimin në mënyrë të tepërt të ujit me cilësi të lartë (të pijshëm) i cili është një burim gjithnjë e më i shtrenjtë.

Një faktor më tepër në favor të Lagunave artificiale për trajtimin e ujërave të zeza është përzjerja totale e tyre me mjedisin (shihni foton sipër). Në vitet e fundit Komuniteti Europian i ka dhënë më shumë prioritet financimit të këtyre sistemeve sesa sistemeve konvencionale të teknologjisë së lartë.

Si shtesë, përdorimi i sistemeve të Lagunave artificiale për trajtimin e ujërave të zeza merr parasysh zgjedhje pastrimi që janë të decentralizuara dhe të përcaktuara për një zonë të dhënë dhe për situata specifike mjedisore. Shmangia e centralizimit dhe e sistemeve të mëdhaja ndihmon për të siguruar mbrojtje më të madhe të balancës hidro- gjeologjike.



Sistem rrjedhës nën sipërfaqësor horizontal që shërbyen si një mundësi agro- turizmi (Firence, Itali)


Sistemet janë veçanërisht të mirë adaptuara për rizgjidhjen e problemeve të pastrimit të ujit në zonat rurale dhe kodrinore ku mbledhja e ujërave në një sistem të centralizuar do të përfshinte kosto të larta dhe impakt negativ mjedisor.

Në zonat skajore dhe të degraduara përdorimi i këtyre sistemeve mund të sigurojë një mundësi për të rivendosur mjedisin.

Aplikimi i sistemeve natyrale merr parasysh zgjidhjen e problemeve higjieno -sanitare të mbeturinave, ndërkohë që bën më të lirë përdorimin e ujit.

Ka shumë tipe të sistemeve të Lagunave artificiale për trajtimin e ujërave të zeza, por ato që janë më gjerësisht të aplikuara në kontekstin European janë si më poshtë:

- Sisteme Rrjedhëse Nën sipërfaqësore Horizontale (SRrNS-H)
- Sisteme Rrjedhëse Nën sipërfaqësore Vertikale (SRrNS-V)
- Sisteme Rrjedhëse Sipërfaqësore (SRrS)



Këto tipe sistemesh mund të përdoren të vetëm ose në kombinime në sisteme të ashtuquajtura “me shumë faza”.

Çdo tip është ndërtuar në mënyrë ndryshe dhe siguron nivele pastrimi veçanërisht ndaj llojit të ndotësit që do të hiqet.

Kjo lejon trajtim të duhur në secilin rast individual, ndërkohë një kombinim i sistemeve bën të mundur madje dhe trajtimin e mbeturinave që ndryshojnë në mënyrë të dukshme nga njëra — tjetra. Për shembull, një shtëpi e izoluar në një vendodhje rurale ose një konsumator privat i shkallës së ulët mund të përdorë tipin më të thjeshtë, një sistem rrjedhëjeje nën sipërfaqësore horizontale, ndërkohë një fabrikë djathi ose një fermë kafshësh do të kërkonte një sistem të kombinuar ku tipe të ndryshme janë zgjedhur sipas objektivave të pastrimit dhe karakteristikave sasiore dhe cilësore të mbetjeve.

Tani në Europë ka rreth 11,370 sisteme të regjistruara zyrtarisht të Lagunave artificiale për trajtimin e ujërave të zeza të monitoruara nga institutet e kërkimit.

Çfarë problemesh zgjidh?

Siç është përmendur më sipër, sistemet e Lagunave artificiale për trajtimin e ujit të papërdorshëm janë një zgjedhje gjerësisht e përdorur në pjesën më të madhe të vendeve të Komunitetit Europian. Universiteti dhe institucionet e kërkimit vazhdojnë të testojnë modele dhe procese kinetike të zhvilluara për tipe të ndryshme të mbetjeve dhe për kushte të ndryshme mjedisore dhe klimaterike, në lidhje me zgjedhjen e strukturave të adaptuara. Ky kërkim ka bërë të mundur madje përdorimin e sistemeve edhe për mbetje që përmbajnë nivele të larta të ndotësve, psh, elemente filtrimi të mbetjeve solide urbane dhe mbeturina zooteknike.

Lagunat artificiale për trajtimin e ujërave të zeza, nëse përdoren për trajtim sekondar të mbetjeve ose (ripërpunim), janë zgjedhje strukturale të qëndrueshme, të afta për pastrim të nivelit të lartë (veçanërisht për parametrat që përfshijnë COD, BOD5, solide të varura dhe sedimentale, ngarkesa mikrobi dhe nitrogen) përmes një operacioni të thjeshtë dhe jo të komplikuar me shumë më pak impakt mjedisor dhe konsum energjie sesa sistemet e tjera të pastrimit. Në shumë raste rrjedha e ujërave lëviz nga graviteti, kështu që sistemet nuk kërkojnë burim energjie.

DISA AVANTAZHE TË PËRDORIMIT TË LAGUNAVE ARTIFICIALE PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË ZEZA

- Rezultate të shkëlqyera të pastrimit
- Kosto operimi të kufizuara
- Mekanizma të thjeshtë veprues
- Konsumim i ulët ose jo ekzistent i energjisë
- Përshtatshmëri ndaj variacioneve të ngarkesës
- Oksigjenim maksimal të rrjedhës së ujërave
- Përzirje maksimale me terrenin
- Mundësi për ripërdorim të ujërave të trajtuara dhe trajtim përmes produkteve
- Restaurim mjedisor të shesheve të degraduara



Detaj i një sistemi rrjedhjeje të lirë në sipërfaqe për një firmë që prodhon verë.

Për më tepër, sistemet e Lagunave artificiale për trajtimin e ujërave të zeza nuk janë të ndikuara nga variacionet në ngarkesën hidraulike për trajtim, ndryshe nga pastruesit konvencionalë të cilët kërkojnë një ngarkesë konstante hidraulike. Kjo nënkupton që për pajisjet ose komunitetet me fluktacione të dukshme gjatë vitit (psh, pajisjet për bërjen e verës, fermat për prodhimin e ushqimit, hotelet, kampingjet, qytetet që merren me turizëm, etj), përdorimi i fitopastrimit të Lagunave artificiale për trajtimin e ujërave të zeza nuk na çon në nivele të reduktuara të pastrimit.

Laguna artificiale per trajtimin e ujërave të zeza të vëna në praktikë

Ka tipe të ndryshme të strukturave që mund të përdoren për Lagunat artificiale për trajtimin e ujërave të zeza në varësi të nevojave të ndryshme dhe sipas një qëllimi të përcaktuar për shkatërrimin e ndotjeve.

Tregon sistem të lirë rrjedhjeje sipërfaqësore (slrr) për trajtimin dhe mbledhjen e ujit të shiut për t'u ripërdorur



Bimët ujore nga klasat *Pragmites*, *Thypha*, *Scirpus* janë përgjithsisht të kultivuara në sisteme, me rrënjët e tyre që zhvillohen në mjedisim mbushës. Bimët veprojnë si pompa natyrale për transferimin e oksigjenit nga atmosfera në mjedisin mbushës të pellgjeve, i cili është i populluar nga koloni bakteresh të afta për dekompozimin e materialit organik nën kushte aerobike dhe për nitrifikimin e tij. Kushtet ideale të mungesës së oksigjenit për procesin e de-nitrifikimit ekzistojnë në zona shumë larg nga rrënjët.

Këto sisteme janë të afta të shkatërojnë 99 % të ngarkesës së mikrobrit, në veçanti sëmundjen e krijuar nga vetë bakterit. Si shtesë, bimët absorbojnë ndonjë metal prezent në ujin e papërdorur, ndërsa inertet mbushëse lejojnë zhvendosjen e fosforitit përgjatë ngurtësimit.

SISTEMET E RRJEDHJEVE NËNTOKËSORE VERTIKALE (SRRN-V)

Këto sisteme rrjedhjeje janë të dallueshme nga ato të rrjedhjeve nëntokësore horizontale nga fakti që rrjedhat e ujërave janë të shpërndara në mënyrë të pandërprerë brenda pellgjeve ujëmbledhëse dhe rrjedha hidraulike në mënyrë dominante është vertikale.

Tipet e sistemeve të mëposhtëme kanë prodhuar rezultate më të kënaqshme në termat e niveleve të pastrimit, impaktit higjienik dhe shëndetësor, duke vepruar në mënyrë të thjeshtë dhe adapte ndaj kushteve të ndryshme mjedisore:

- Sistemet e Rrjedhjejeve Nëntokësore Horizontale
- Sistemet e Rrjedhjeve Nëntokësore Vertikale
- Sistemet e Rrjedhjeve Sipërfaqësore

SISTEMET E RRJEDHJEVE NËNTOKËSORE HORIZONTALE (SRRN-H)

Këto sisteme ngjajnë me pellgje ujëmbledhëse të zhytura në tokë, rreth një metër thellë dhe të bërë të padepërtueshëm nga një membranë sintetike e zgjatur përgjatë fundit të pellgut. Pellgu është mbushur me materiale inerte, zakonisht zhavorr i hollë dhe gur të shtypur, granulometria e të cilëve është zgjedhur me kujdes për të lejuar difuzion optimal të rrjedhës së ujërave në pellg.

Uji i papërdorur është paraqitur në sistem përmes një tubi të brimuar që përshkon gjatësinë tërthore të pellgut e më pas filtron ngadalë përmes materialit mbushës në sajë të një pjerrjeje të lehtë (mes 1 dhe 5 %) në tabanin e pellgut. Uji mbetet gjithmonë nën sipërfaqe derisa arrin një tub drenazhimi që e lejon të dalë nga sistemi.

Një tjetër diferencë është përdorimi i një tipi ndryshe të mjedisit mbushës të përbërë nga disa shtresa të shkallëve të ndryshme të granilit dhe rërës, nga një shtresë e rërës në sipërfaqe e deri te një shtresë gurësh të shtrirë mbi sistemin e drenazhimit në fund të pellgut.

Metoda e sistemit vertikal të ushqimit përmes spërkatjes brenda në sistem lejon që më shumë oksigjen të paraqitet në rrjedhat e ujërave dhe si rezultat një kapacitet të përmirësuar për të shkatërruar materialin organik.

Në këto sisteme, ujërat po ashtu mbesin nën sipërfaqen e pellgut dhe janë përdorur të njëjtat bimë si dhe për sistemet e rrjedhjes horizontale.

SISTEMET E RRJEDHJEVE TË LIRA NË SIPËRFAQE

Këto sisteme konsistojnë në një peggll ujëmbledhës të cekët, të izoluar me një membranë sintetike në të cilën ujërat rrjedhin lirshëm në sipërfaqe. Ato variojnë në lartësi mes pak centimetrave dhe një metër.

Sistemi është i konceptuar në një mënyrë të tillë sa të krijojë mjediset e duhura për një varietet të bimëve, nga bimët ujore që jetojnë nën ujë deri te bimët që rrinë mbi ujë, nga bimët helofite që jetojnë mbi brigje te bimët hidrofile me rrënjë të ekspozuara.

Bimësia është zgjedhur sipas një seri kriteresh që lejojnë për një riprodhim tepër të besueshëm të biodiversitetit të një zonë të lagur në mënyrë natyrale ndërkohë garantohet një potencial maksimal pastrimi.

Secila specie e bimësisë krijon një seri të funksioneve specifike brenda sistemit. Këto përfshijnë oksigjenimin e ujit në të cilin ato gjenden dhe absorbimin e substancave nutritive të pranishme (fosfat, nitrat, etj) që janë të nevojshme për rritjen e bimëve. Të gjitha llojet e bimëve sigurojnë një taban toke të përshtatshëm që nxit zhvillimin e mikroorganizave të rëndësishme për proceset pastruese të zonave të lagura në mënyrë natyrale.

Bimësia përgjithësisht e përdorur për këto sisteme i përket klasave Pragmites, Thypha, Scirpura, Iris, Nymphaea, Juncus, Carex, Alisma, Myriophyllum, Ceratophyllum, Butomus, Patomogetum, etj. Në çdo rast është një praktikë e mire për të përdorur bimë autoktone që nuk ndryshojnë me mjedisin natyral dhe që nuk janë të dëmshme ose invazive ndaj zonave fqinje.



Ilustrim skematik i një sistemi rrjedhjeje nësipërfaqësore horizontale (në mes) të një rrjedhjeje vertikale dhe në fund të një rrjedhjeje të lirë.




Rezultatet

Zgjedhja e sistemit për përdorim varet nga nevojat e pastrimit të rrjedhës së ujit ose ujit të papërdorshëm. Përgjithësisht sistemet e rrjedhjeve nënsipërfaqësore horizontale janë përdorur për të zhvendosur materialin e biodegradueshëm biologjikisht dhe kimikisht dhe materialet solide të varura; Ato kanë një efikasitet zhvendosjeje të një rendi 90 % për këta ndotës.

Figura më poshtë tregon të dhënat mesatare të mbledhura në rreth 260 shembuj të sistemeve të lokalizuara në vende të ndryshme Europiane, në terma të cilësisë të rrjedhjave të ujërave dhe parametrave kryesore. Për faktin se ato oksigjenojnë plotësisht mirë, sistemet e rrjedhjes vertikale janë të përshtatshme për optimizimin e procesit të nitrifikimit dhe kështu për shkatërrimin e nitrogenit.


Sistemet e rrjedhjes në sipërfaqe, të përdorura vetëm pas trajtimeve të përshkruara më sipër lejojnë një shkatërrim të mëtjeshëm të ndotësve mbetës.

Disa të dhena domethënëse mbi cilësinë e rrjedhës së ujërave të dala nga sistemet e rrjedhjeve të lira në sipërfaqe të aplikuara si një trajtim i tretë janë treguar në figurat e më poshtme:



Sistemet me shumë faza janë përdorur me frekuencë të rritur me qëllim të sigurimit të shkatërrimit në rritje të ndotësve dhe kështu për të optimizuar performancën e sistemeve natyrale të pastrimit.

Skema tipike e një sistemi me shumë faza është paraqitur në diagramën si në figurë.



• TRAJTIMI PRIMAR

Rezervuar si një sedimentues për eliminimin e pjesëve më të papërpunuara të ujit të papërdorur;

• TRAJTIMI SEKONDAR

Sistem rrjedhjeje nënsipërfaqësore horizontale për shkatërrimin e pjesës më të madhe të lëndës organike dhe materiale solide të varura të shfaqura pas trajtimit primar;

• TRAJTIMI I TRETË

Sistem i rrjedhjes së lirë në sipërfaqe për përmirësimin e pastrimit (veçanërisht denitrifikimit) dhe mbledhjes së rrjedhës së pastruar;

Sistemi lejon ripërdorimin e ujit.

ASPEKTE OPERACIONALE

Siç u përshkrua më sipër, falë thjeshtësisë së tyre për t'u ndertuar dhe mirëmbajtur, sistemet janë veçanërisht të duhura për komunitetet e vogla dhe të mesme dhe mjediset rurale. Nuk ka nevojë për punë të specializuar për të menaxhuar aspektet operationale që sistemet kërkojnë.

Pjesa më e rëndësishme e aspekteve ka të bëjë me drenazhimin e rregullt të rezervuarit septik të vendosur në drejtim të kundërt të rrjedhjes nga sistemi i fitopastrimit dhe kontrollin e nivelit të



ujit në shtrat (shërben gjithashtu për të parandaluar rritjen e barërave të këqija) dhe kushtin e bimësisë.

Kontrollimi i nivelit të ujit në mënyrë themelore konsiston si më poshtë:

Mbajtja e rrënjëve dhe rizomeve të hidrofiteve në kontakt me ujin.

Parandalimi i rritjes të barrërave të këqija invazive që kanë tendencë për të mbizotëruar, veçanërisht në zona jo të ngopura të shtratit gjatë pak muajve të parë kur sistemi është në veprim.

Mirëmbajtja e vetme e bimëve përfshin mbikëqyrjen sesi ato rriten në mënyrë normale dhe sigurojnë po në mënyrë normale pastrim manual periodik të bimësisë çdo dy/tre vjet; procesi duket se rivitalizon bimësinë dhe stimulon më fuqishëm dhe më uniform një rritje të re.

Sistemi i rrjedhjes së lirë në sipërfaqe kërkon madje pak menaxhim operacional, ndërsa sistemi është dizenuar për t'u zhvilluar në menyren natyrale më të mirë të mundshme. Kositja është e pritshme çdo tre vjet.

AVANTAZHET

Në lidhje me avantazhet pothuajse të përmendura, Lagunat artificiale për trajtimin e ujërave të zeza bëjnë të mundur:

- Ripërtëritjen e nutrientëve që nga ana tjetër do të kishim një impakt negativ mjedisor;
- Promovojnë një riciklim llogjik që mbyll ciklin e disa nutrientëve si nitrogeni dhe fosfori brenda zonave të prodhimit;
- Pastron ujërat për t'i ripërdorur ato për qëllime vaditjeje; kjo krijon një cikël të mbyllur të përdorimit të ujit dhe çon në kursime të dukshme të furnizimeve të ujit të pijshëm i cili mund të lihet mënjanë vetëm për konsum.

Lagunat artificiale për trajtimin e ujërave të zeza janë një zgjedhje e qëndrueshme për trajtimin e ujit të papërdorshëm dhe janë të afta për të përmirësuar kapacitetet e pastrimit të strukturave ekzistuese po ashtu dhe për reduktimin e ndotjes së kanaleve të ujit në lëvizje dhe ndotjen e burimeve të ujit.

Interesi ndërkombëtar

Përfundimisht është një zgjedhje me avantazh të madh për të përdorur sisteme të trajtimit natyral në kontekstin e vendeve me mungesë të burimeve të mëdha ekonomike ose teknologji të avancuara.

Instalimi i sistemeve nuk kërkon përdorimin e personelit të trajnuar apo teknika ndërtimi të sofistikuar. Sistemet e Lagunave artificiale për trajtimin e ujërave të zeza mund të ndërtohen duke përdorur fuqinë punëtore lokale të përshtatshme të patrajnuar dhe burime të

përshtatshme lokale zakonisht jo për rastin e sistemeve konvencionale të pastrimit.

Vënia në punë e sistemeve kërkon shumë pak inpute ekonomike: Në pjesën më të madhe të rasteve Lagunat artificiale për trajtimin e ujërave të zeza nuk kërkojnë burime të dhëna energjie që ato të funksionojnë përmes gravitetit dhe përmes proceseve natyrale të pastrimit. Te tilla mirëmbajtje të thjeshta çojnë në mënyrë të dukshme drejt reduktimeve në kosto.



Në përfundim, zgjedhja për të përdorur sistemet e Lagunave artificiale për trajtimin e ujërave të zeza nënkupton në terma socialo — ekonomike mundësinë e kënaqjes me përfitimet që rrjedhin nga menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve të ujit, duke kufizuar varfërimin e kanaleve me ujë të rrjedhshëm dhe duke optimizuar konsumin me rrjedhoja pozitive për ekonominë e rajonit dhe vendit dhe duke mos u mbështetur në strukturat që janë tepër të kushtueshme për t'u vënë në veprim.

Vendet që e kanë kthyer vëmendjen nga përdorimi i Lagunave artificiale për trajtimin e ujërave të zeza si pjesë e një politike mbështetjeje më të madhe ekonomike dhe mjedisore po aq sa edhe për avantazhet e përmendura më sipër, përfshijnë Slloveninë, Tunizinë dhe Egjiptin.

Adoptimi i lagunave artificiale për trajtimin e ujërave të zeza në vendet e tjera

Përdorimi i sistemeve të pastrimit të ujit të Lagunave artificiale për trajtimin e ujërave të zeza nuk është i lidhur me ndonjë kufizim ligjor: kjo nuk ka të bëjë me një produkt të përfunduar por për më tepër me atë se çfarë do të ndodh me një projekt që nuk kërkon teknologji speciale për t'u implementuar dhe mund të krijohet shumë lehtësisht nga firmat lokale. Për më tepër, për derisa ato nuk janë të bazuara mbi një koncept të modeleve ose standarteve, projekti duhet të dizajnohet për këtë qëllim për çdo situatë.

Profesionalistët të cilët formojnë grupet e dizajnit duhet të jenë shumë të arsimuar si biologë, kimistë ose për shembull inxhinierë dhe duhet të marrin trainim të specializuar në dizajnimin dhe dimensionimin e sistemeve të Lagunave artificiale për trajtimin e ujërave të zeza.

Menaxhimi i sistemeve nuk kërkon personel të trajnuar dhe mund të bëhet përmes rezultatit që marrim prej tij përmes aftësisë së kostove të tij minimale.

Në rastin e problemeve specifike është më e drejtë të kontaktojmë personel teknik të specializuar dhe nëse është e nevojshme njësinë përgjegjëse për dizajnimin e sistemit, me të cilin mund të hartohet një tip i kontratës së asistencës për përdoruesit. Në fakt, do të ishin përdoruesit të cilët do marrin përfitimet e përdorimit të sistemit, psh përmes ripërdorimit të ujit të trajtuar.

Disa nga institucionet që mund të përfshiheshin në përpilimin e studimit të fisibilitetit për aplikimin e sistemeve përfshijnë institucione kerkimi, universitete, dhe specialistë ose teknikë në fushën e menaxhimit të integruar dhe eko—mbështetës të ujit.



Detaje të një sistemi me shumë faza që konsiston në një sistem të rrjedhjes nënsipërfaqësore horizontale (në të djathtë) dhe atij vertikal në të majtë në shërbim të një strukture turistike – ekuivalente me 140 banorë.

■ Për më shumë informacion

Për të mësuar më shumë rreth sistemeve të Lagunave artificiale për trajtimin e ujërave të zeza mund të gjendet informacion i mëtejshëm në adresat e internetit:

www.irdra.com,
www.arpat.toscana.it/publicazioni linku: catalogo publicazioni anno 2003

Mund të transkribohet një bibliografi, publikime shkencore, minuta nga kongreset ndërkombëtare dhe të dhëna nga monitorimi i realizuar mbi sistemin italian.

■ Kë të kontaktojmë?

ARPAT

Agjensia Rajonale për Mbrojtjen Mjedisore të Toskanës

ZYRAT QËNDRORE

Rruga Nikola Porpora, 22
50144 Firenze Itali
e-mail: ideas@arpat.toscana.it



Si shtesë, ARAPAT është i gatshëm të sigurojë asistencë konsulente dhe teknike për dizejimin, metodologjinë operative, dhe menaxhimin e sistemit. Një teknik nga ARPAT është në gjendje të përpilojë monitorimin e të dhënave në sistem të nxjerra nga analiza të kryera nga aktorë lokale si universitetet, institutet e kërkimit operatorë të sistemeve të pastrimit.

BEATRICE PUCCI

Telefoni: [+39] 055-470729
Fax: [+39] 055-475593
e-mail: b.pucci@cw.ideass.org



Initiativa IDEASS – Inovacione për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Jug – Jug është promovuar nga programet e mëposhtme për bashkëpunim ndërkombëtar: ILO/Universitas, UNDP/APPI, dhe UNDP/IFAD/UNOPS Programet për Zhvillim Njerëzor dhe Programet Kundër Varfërisë, aktualisht prezente në Shqipëri, Angola, Kolumbi, Kubë, El-Salvador, Guatemalë, Honduras, Mozambik, Nikaragua, Republikën Domenikane, Serbi, Afrikën e Jugut e Tunizi. Iniciativa e bashkëpunimit është rezultat i Samiteve Botërore në vitet 1990 dhe i Asamblesë e Përgjithshme të Mileniumit; ajo i jep përparësi bashkëpunimit mes protagonistëve në Jug, me mbështetjen e vendeve të industrializuara.

Qëllimi i IDEASS është të forcojë efektivitetin e proceseve të zhvillimeve lokale përmes përdorimit në rritje të inovacioneve për zhvillim njerëzor dhe kushte të mira pune. Përmes projekteve të bashkëpunimit jug-jug, ata veprojnë si një katalizator për përhapjen e inovacioneve sociale, ekonomike dhe teknologjike që favorizojnë zhvillimin ekonomik dhe social në nivel lokal. Inovacionet e promovuara mund të jenë produkte, teknologji, ose praktika sociale, ekonomike, ose kulturore. Për më tepër informacion rreth Inicativës IDEASS vizitoni faqen e internetit: www.ideassonline.org

IDEASS

Inovacion për Zhvillimin e Bashkëpunimit Jug - Jug



Programi i PNUD-it Iniciativës e Partneritetit Kundër – Varfërisë (APPI) është një program i projektuar për të ndihmuar qeveritë dhe aktorët socialë për të vendosur dhe zbatuar politika kombëtare për uljen e varfërisë dhe përjashtimit social, bazuar në praktikën e zhvillimit të integruar dhe gjithëpjesëmarrës në nivel lokal.



Programet për zhvillim njerëzor dhe kundër varfërisë të zbatuara UNDP, IFAD, ILO, dhe UNOPS përkrahin proceset e zhvillimit lokal të integruar dhe gjithëpjesëmarrës brenda kornizës së politikave kombëtare, me mbështetjen e aktoreve publikë, privatë, dhe shoqërisë civile. Këto programe sigurojnë kornizën brenda së cilës vendet dhuruese dhe komunitetet në vendet e industrializuara mund të bashkëpunojnë në mënyrë të organizuar, përmes bashkëpunimit të decentralizuar. Brenda kësaj kornize do të realizohen dhe bashkëpunimet jug – jug përmes Iniciativës.



Programi ILO/Universitas (punë korrekte përmes trajnimit dhe inovacionit) inkurajon përdorimin e zgjidhjeve inovative të problemeve në zhvillimin njerëzor, veçanërisht në botën e punës. Për të arritur këtë, ai kryen veprimtari kërkimore dhe trajnon vendim-marrësit dhe personelin që punon për zhvillimin lokal.



Në Shqipëri, IDEASS është një iniciativë e programit PASARP (Programi i Aktiviteteve në Mbështetje të Qarqeve dhe Prefekturave Shqiptare), realizuar nga IFAD/UNOPS me fondet e bashkëpunimit italian.